



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË


DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE

SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 83/Prot.

Tiranë, më 3.10.2025



NJOFTIM PUBLIK

**"PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR Z.
GENTJAN BRAMO NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 62-2024-61-65 (1180) DATË
26.11.2024, TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER"**

Lagija 1 Maji, rruga Jani Bakalli, Bashkia Fier.

Referuar vendimit nr. 62-2023-3259 (553) datë 07.09.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku znj. Aneta Bramo, është përfituese e Ndihmës Juridike Dytësore, referuar procesit gjyqësor me objekt *"Kërkesë për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet proceduriale deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë"*.

Me Vendimin nr. 62-2024-61-65(1180) datë 26.11.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Fier, në procesin me palë paditëse znj. Aneta Bramo dhe të paditur z. Gentjan Bramo me objekt *"Zgjidhja e martesës ligjore mes paditëses dhe të paditurit, Lënien paditëses për rritje dhe edukim të fëmijës të mitur Albana Bramo, e datëlindjes 30.08.2007, Detyrimi i palës të paditur të paguajë detyrimin për ushqim për fëmijën Albana Bramo, në masën 20,000 (njëzet mijë) lekë në muaj. Caktimin e të drejtës të takimit me fëmijën për prindin të cilit nuk do ti lihet fëmija për rritje dhe edukim, Pas zgjidhjes të martesës, paditësja të rimarrë mbiemrin që ka pasur para martese, atë "Murati", ka vendosur:*

1. *Pranimin e padisë.*
2. *Zgjidhjen e martesës midis paditëses Aneta Bramo me Nr. Personal H76010092R dhe të paditurit Gentjan Bramo me Nr. Personal H51029044M.*
3. *Paditësja Aneta Bramo pas zgjidhjes së martesës të marrë mbiemrin që ka pasur para martese, atë "Murati".*
4. *Lënien për rritje dhe edukim paditëses, nënës të saj Aneta Bramo, të fëmijës të mitur Albana Bramo me Nr. Personal K75830051O.*
5. *Detyrimin e të paditurit Gentjan Bramo të paguajë detytinin për ushqim për fëmijën Albana Bramo në masën 20,000 (njëzet mijë) Lekë në muaj. Ky detyrim fillon nga dita e ngritjes së padisë, datë 28.09.2023. Pagesa do të bëhet çdo muaj nga data 1 në datën 10 të fillimit të muajit përkatës, në llogarinë bankare në monedhën Lekë në emër të paditëses Aneta Bramo.*

6. I padituri Gentjan Bramo ka të drejtë të takojë fëmijën e mitur Albana Bramo si vijon: ta marrë fëmijën Albana Bramo javën e parë dhe të tretë të çdo muaji, nga ora 10:00 e ditës të shtunë deri në orën 14:00 të ditës të diel; ta marrë fëmijën Albana Bramo për pushimet verore nga data 1 deri në datën 15 të muajit gusht të çdo viti; ta marrë fëmijën Albana Bramo në pushimet e fundvitit, nga data 20 deri në datën 28 dhjetor të çdo viti çift, dhe nga data 28 dhjetor deri në datën 5 janar të çdo viti tek.
7. Një kopje e këtij vendimi, pasi të marrë formë të prerë t'i dërgohet Zyrës së Gjendjes Civile 153, Njësia Administrative Fier, Bashkia Fier, e cila urdhërohet të bëjë veprimet përkatëse sipas këtij vendimi.
8. Dhe në pikën 8 të dispozitivit të vendimit Shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim palëve ndërgjyqëse solidarisht, në masën 50% secili.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimin e ofruara ekspertin Bujana Nurellari me vlerë 40 000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" si dhe Kodit të Proedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit nr. 62-2024-61-65(1180) datë 26.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, të shumës prej 40 000 lekë, të parapaguara nga ana jonë për shpërblim eksperti, ofruar për përfituesin e ndihmës juridike dytësore falas znj Aneta Bramo.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Gentjan Bramo. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Bashkinë Fier, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë. Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Fier depoziton në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
NË MUNGESË**

**(DREJTOR I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDIHMËS PARËSORE)**

Patricia Pogace